

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

**Objekti:** Blerje materiale ndërtimi

**Fondi limit:** 14 581 750 (katërbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) Lekë pa tvsh.

**Skicimet, parametrat teknik etj:**

### **1. Astar epoksid dy komponentesh me bazë uji**

Astari i cili vendoset para se të aplikohet hidroizoluesi. Te kete veti shume te mira ngjitese dhe hidroizoluese. Te jete i pershtatshem per perdorim ne te gjitha siperfaqet poroze duke rritur ndjeshem ngjitshmerine midis hidroizoluesve me baze elastomeresh dhe suportit. Temperatura e aplikimit: +5 °C deri ne +35°C. Forca ngjitëse  $\geq 4\text{N/mm}^2$ . Paketimi 1kg-5kg.

### **2. Astar me bazë rezine akrilike**

Astar me bazë rezine akrilike, i cili përdoret për t'i dhënë suportit cilësitë e dëshiruara para aplikimit të ngjitësve të pllakave me bazë çimento. Ky produkt mund të aplikohet si shtresë parësore në shumë suporte, si për shembull pllaka të vjetra, sipërfaqe të lëmuara, gurë natyral, sipërfaqe dyshemeje të çimentuara, dru dhe metal. Paketimi 1kg-5kg.

### **3. Astar antikorrozion**

Astar me veti penetruese dhe mbrojtëse të strukturave metalike. Ky produkt të ketë veti penetruese dhe mbrojtëse të strukturave metalike dhe ngjitshmëri shumë të mirë duke siguruar mbrojtje të strukturës metalike në brendësi nga procesi i korrodimit. Paketimi 1kg-5kg.

### **4. Allçi**

Allçi me bazë gipsi me ngrirje të shpejte për montimin e kutive dhe tubave elektrikë dhe procese të tjera të nevojshme në fushën e ndërtimit. Rezistent ndaj goditjeve elektrike, i aplikueshëm në të gjitha suportet me përmbajtje minerale dhe të absorbueshëm. Paketimi 1kg-5kg.

### **5. Arkitrarë betoni të parapërgatitur**

Arkitrarë betoni të armuar me seksion 14cmx4cm, 15cmx15cm, 16cm, x16cm. Lloji i betonit të përdorur të jetë M200-M300. Në gjatësinë e arkitraut të ketë minimalisht katër shufra hekuri për ndërtim me diameter Ø8mm me stafa hekuri Ø6mm çdo 10-12cm largësi nga njëra-tjetra. Gjatësia sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

### **6. Bashkues ulluqesh horizontale Pvc**

Bashkueset e ulluqeve duhet te jene te perbera prej materiali PVC cilesore, te jene me peshe te lehte dhe ngurtesi te larte per te perballuar forcat mekanike apo qe lindin si pasoje e shkarkimeve te ujit.

### **7. Blloqe betoni 20cmx20cmx40cm**

Blloqe e betonit duhet te jene te jene te perbera prej betoni cilesor, duhet te kene soliditet te larte.

### **8. Mbushës fugash me bazë çimento (bojak)**

Stuko për mbushjen e fugave me bazë çimento me granulometri të seleksionuar dhe me një qëndrueshmëri të lartë ndaj ujit shërben për mbushjen e fugave nga 0 - 5 mm. Të jetë material në formë pluhuri me bazë çimento, me pluhur guri natyral me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike, aditivë hidrofobikë dhe pigmente ngjyruës. Bojaku duhet të jetë cilesor. Ngjyrat sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Rezistenza në ngjeshje  $\geq 28 \text{ N/mm}^2$ . Paketimi 1kg-5kg.

### **9. Ngjyruës për beton dhe rifinitura**

Të jetë i përshtatshëm për të ngjyrosur llaçin e tjegullave ose betonime me ngjyrë etj. Paketimi 1kg-2kg.

### **10. Bordura betoni**

Bordura betoni me seksion 15cmx15cmx50cm. Lloji i betonit të përdorur të jetë M200-M300. Gjatësia sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

### **11. Brryla katrore për ulluqe**

Brrylat duhet të jenë të perbera prej materiali PVC cilesor ku të shfaqin rezistencë ndaj agjenteve atmosferikë.

### **12. Brryla për ulluqe horizontale**

Brrylat duhet të jenë të perbera prej materiali PVC cilesor ku të shfaqin rezistencë ndaj agjenteve atmosferik dhe të përshtatshëm për instalime në ulluqet horizontale.

### **13. Çimento 32.5R**

Çimento duhet të jetë e tipit Portland me gurë gëlqeror. Çimento duhet të jetë cilesor dhe me paketim hermetik kundër lagështirës. Përbërja: klinker  $\geq 65\%$ , gur gëlqeror  $\leq 35\%$ , përbërës të tjerë  $\leq 5\%$ . Ambalazhimi të jetë me thasë 20-30 kg.

STANDARTET TEKNIKE QË DUHET TË PLOTËSOJË:

Standartin Teknik Shqiptar SSH EN 197-1:2011 Çimento - Pjesa 1: Përbërja. karakteristikat dhe kriteret e konformitetit për çimentot e zakonshme ose ekuivalentin e tij.

### **14. Çimento Klasa 42.5R**

Çimento duhet të jetë e tipit Portland me gurë gëlqeror. Çimento duhet të jetë cilesor dhe me paketim hermetik kundër lagështirës. Përbërja: klinker  $\geq 80\%$ , gur gëlqeror  $\leq 20\%$ , përbërës të tjerë  $\leq 5\%$ . Ambalazhimi të jetë me thasë 20-30 kg.

STANDARTET TEKNIKE QË DUHET TË PLOTËSOJË:

Standartin Teknik Shqiptar SSH EN 197-1:2011 Çimento - Pjesa 1: Përbërja. karakteristikat dhe kriteret e konformitetit për çimentot e zakonshme ose ekuivalentin e tij.

### **15. Davanciale dritaresh (mermeret)**

Material mermeri. Permasat: trashësia 20mm, gjerësia dhe gjatësia sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të jetë me sipërfaqe të lemuar.

### **16. Ngjitës për pllakat qeramike (kollë)**

Ngjitës me bazë çimento, për ngjitjen e pllakave qeramike. Ky produkt përdoret për shtrimin e pllakave qeramike, pllaka të dimensioneve të vogla në sipërfaqe të ndryshme të tilla si: beton, dysheme me bazë çimento e suva. Të jetë i përshtatshëm për ambiente të brendshme. Ambalazhimi të jetë me thasë 20-30 kg.

### **17. Fasheta dhe kapëse ulluqesh**

Fashetat ulluqesh bejne te mundur kapjen në mur apo beton të ullqeve horizontal dhe vertikalë. Fashetat duhet te jene me diameter sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

### **18. Fasheta metalike Ø110mm**

Fashetat metalike bejne te mundur kapjen ne soleta apo mur te materialeve ndertimore ne kantier ndertimi. Fashetat duhet te jene me diameter 110mm.

### **19. Fasheta metalike Ø100mm**

Fashetat metalike bejne te mundur kapjen ne soleta apo mur te materialeve ndertimore ne kantier ndertimi. Fashetat duhet te jene me diameter 100mm.

### **20. Fasheta metalike Ø80mm**

Fashetat metalike bejne te mundur kapjen ne soleta apo mur te materialeve ndertimore ne kantier ndertimi. Fashetat duhet te jene me diameter 80mm.

### **21. Fasheta metalike Ø75mm**

Fashetat metalike bejne te mundur kapjen ne soleta apo mur te materialeve ndertimore ne kantier ndertimi. Fashetat duhet te jene me diameter 75mm.

### **22. Fasheta metalike Ø50mm**

Fashetat metalike bejne te mundur kapjen ne soleta apo mur te materialeve ndertimore ne kantier ndertimi. Fashetat duhet te jene me diameter 50mm.

### **23. Fasheta metalike Ø40mm**

Fashetat metalike bejne te mundur kapjen ne soleta apo mur te materialeve ndertimore ne kantier ndertimi. Fashetat duhet te jene me diameter 40mm.

### **24. Fasheta metalike Ø25mm**

Fashetat metalike bejne te mundur kapjen ne soleta apo mur te materialeve ndertimore ne kantier ndertimi. Fashetat duhet te jene me diameter 25mm.

### **25. Fasheta plastike Ø 40mm**

Fashetat plastike bejne te mundur kapjen e soleta apo mur te materiale ndertimore ne kantier ndertimi. Fashetat duhet te jene me diametër 40mm.

### **26. Fino suvatimi**

Të jetë material në formë pluhuri që parandalon krijimin e mykut dhe lejon transpirimin e murit me bazë çimentoje, gëlqereje të hidratuar, rëre guri karbonik dhe mermeri me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike dhe aditivë specialë. Produkti të karakterizohet nga hapje dhe punueshmëri mjaft e mirë dhe mbulueshmëri e lartë. Të ketë aplikimin në sipërfaqe të jashtme edhe të brendshme të mbushura si me llaç tradicional ashtu edhe me llaç të parapërgatitur. Ky produkt të jetë i aplikueshëm në një trashësi deri në 3 mm. Mund të mbulohet me bojë, ose me veshje të tjera me natyrë minerale dhe sintetike. Rezistenca në shtypje mbas 28 ditëve  $\geq 4 \text{ N/mm}^2$ . Rezistenca në përkulje mbas 28 ditëve  $\geq 2 \text{ N/mm}^2$ . Temperatura e ruajtjes  $+5^\circ\text{C}$  deri ne  $+35^\circ\text{C}$ . Ambalazhimi të jetë me thasë 20-30 kg.

### **27. Gaz për djegie**

Gaz per perdorimin e izolimit te taracave.

## **28. Gëlqere**

Gëlqere ne thase 5-8 kg per aplikime ndertimi.

## **29. Pllakë gips çimentato+aksesore (profile,vida, upa)**

Pllaka duhet të jetë e ngjeshur dhe e aftë të punojë nën ndikimin e presioneve të larta mekanike. Të jetë jo e djegshme dhe me sipërfaqe optimale për mbajtjen e suvasë. Të përbëhet nga një bërthamë prej çimento dhe materiale të tjera shtesë dhe të jetë e përforcuar nga të dyja anët me fibra qelqi. Dimensionet: Gjerësia: 1200mm ± 10mm, Gjatësia: 2400mm ± 10mm, Trashësia: 12mm ± 1mm, Peshë specifike:  $\geq 1400 \text{ kg/m}^3$ , Rezistenca mekanike:  $\geq 6 \text{ Mpa}$ . Të jenë të përfshira vidat vetëfiletuese (25/39/55 mm) dhe vida kokpunto (25/39 mm) të cilat shërbejnë për fiksimin e pllakave sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

STANDARTET TEKNIKE QË DUHET TË PLOTËSOJË:

Standartin Teknik Shqiptar SSH EN 12467:2012+A2:2018 Fletë të sheshta çimentoje me fibër - Specifikim produkti dhe metodat e provës, ose ekuivalentin e tij.

## **30. Pllakë gips për aplikim në mur dhe tavan, së bashku me elementët strukturor të montimit, vida, profilet, kapset etj**

Gipsi duhet të jetë cilësor dhe i strukturuar mirë gjithashtu duhet të ketë dhe elementët e montimit si vida, profila, vida etj. Dimensionet: Gjerësia: 1200mm ± 10mm, Gjatësia: 2600mm ± 10mm, Trashësia: 12.5mm ± 1mm, Densiteti:  $\geq 600 \text{ kg/m}^3$ . Të jenë të përfshira vidat vetëfiletuese (25/39/55 mm) dhe vida kokpunto (25/39 mm) të cilat shërbejnë për fiksimin e pllakave sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

STANDARTET TEKNIKE QË DUHET TË PLOTËSOJË:

Standartin Teknik Shqiptar SSH EN 520:2004+A1:2009 Pllaka gipsi - Përcaktime, kërkesat dhe metoda testimi, ose ekuivalentin e tij.

## **31. Grafiato**

Veshje dekorative që shërben për trajtimin e fasadave dhe sipërfaqeve të brendshme dhe të jashtme. produkti të jetë i përshtatshëm për krijimin e veshjeve dekorative me cilësi mjaft të mira hidroizoluese ngjithëse dhe elastike dhe të përdoret për krijimin e veshjeve dekorative mbi sipërfaqe të mbushura me llaç çimento ose përdoret në sistemet e jashtme termoizoluese si veshje dekorative.

Trashësia e inertit: 1-3 cm sipas porosisë, Peshë specifike: 1300-1600 kg/m<sup>3</sup>. Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C. Konsumi nga 2-4 kg/m<sup>2</sup> sipas përdorimit. Ambalazhimi të jetë me thasë 20-30 kg.

## **32. Gozhdë betoni**

Produkte që aplikohet ne fushën e ndërtimit që bëjnë të mundur lidhjen apo fiksimin e konstruksioneve të ndryshme. Në varësi të projekteve apo përdorimit të tyre si për shembull, në çati, mure të thata apo beton, përdorimi dhe prodhimi i tyre rritet me rritjen e teknologjisë së ndërtimit. Llojshmëria e tyre lidhet ngushtë dhe ndryshon sipas nevojave. Përmasat sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

## **33. Gominë për fuga betoni**

Gominë e përshtatshme për mbylljen e fugave ndërmjett hapësirave të betonit.

## **34. Hekur kuadrat 12x12 mm**

Hekuri profil kuadrat me seksion 12x12 mm te pershtatshem per struktura konstruksioni. Spesori 1.5mm.

### **35. Hekur kuadrat 14 x 14mm**

Hekuri profil kuadrat me seksion 14x14 mm te pershtatshem per struktura konstruksioni. Spesori 1.5mm.

### **36. Hekur kuadrat 15x15 mm**

Hekuri profil kuadrat me seksion 15x15 mm te pershtatshem per struktura konstruksioni. Spesori 1.5mm.

### **37. Hekur kuadrat 20x20 mm**

Hekuri profil kuadrat me seksion 20x20 mm te pershtatshem per struktura konstruksioni. Spesori 1.5mm.

### **38. Hekur betoni Ø12mm**

Hekuri te jete i tipit periodik i pershtatshem per aplikime betoni. Permasa Ø12mm.

### **39. Hekur betoni Ø10mm**

Hekuri te jete i tipit periodik i pershtatshem per aplikime betoni. Permasa Ø10mm.

### **40. Hekur betoni Ø8mm**

Hekuri te jete i tipit periodik i pershtatshem per aplikime betoni. Permasa Ø8mm.

### **41. Hekur betoni Ø6mm**

Hekuri te jete i tipit periodik i pershtatshem per aplikime betoni. Permasa Ø6mm.

### **42. Hekur profil U me vrima**

Ky produkt perdoret per te ndertuar konstruksionet metalike ne banesa, ne ndertesa civile dhe industriale, kapanone etj. Profili te jetë i perbere nga hekur i cilesise se larte, nga material i paster e jo i riciklueshem per te siguruar jetegjatesi dhe fortësi ndaj goditjeve mekanike. Bashkimi i tij behet me ane te saldimit. Hekuri me profil U te jete i pershtatshem per struktura metalike dhe i pershtatshem per aplikimet e kangjellave apo rrethimeve te ambjenteve te jashtme. Permasat sipas kerkesave te autoritetit kontraktor.

### **43. Hekur profil U për kangjella (dimensionet)**

Ky produkt perdoret per te ndertuar konstruksionet metalike ne banesa, ne ndertesa civile dhe industriale, kapanone etj. Profili te jetë i perbere nga hekur i cilesise se larte, nga material i paster e jo i riciklueshem per te siguruar jetegjatesi dhe fortësi ndaj goditjeve mekanike. Bashkimi i tij behet me ane te saldimit. Hekuri me profil U te jetë i pershtatshem per struktura metalike dhe per aplikimet e kangjellave apo rrethimeve te ambjenteve te jashtme. Permasat sipas kerkesave te autoritetit kontraktor.

### **44. Hidroizolues bikomponent për ambiente të jashtme**

Material hidroizolues dy komponentesh me bazë çimentoje, me elasticitet dhe granulometri të seleksionuar, aditivësh specialë dhe polimere sintëtikë në dispersion ujor dhe me funksion mbrojtës për tarraca. Duke përzier dy komponentët, përftohet një masë që mund të aplikohet edhe në sipërfaqe vertikale, me një trashësi deri në 1 mm për shtresë dhe falë përmbajtjes së lartë të rezinave sintëtikë dhe cilësive të tyre, ai garanton një ngjitje të shkëlqyer në të gjitha sipërfaqet e betonit, tullave dhe qeramikës. Pas fortësimit, ai krijon një shtresë hidroizoluese dhe elastike, rezistente ndaj agjentëve atmosferikë. Të jetë i pershtatshem për shtrimin e membranave hidroizoluese për ambiente taracash. Të realizojë mbrojtje fleksibile dhe rezistente ndaj ujit e lagështirës për sipërfaqet e betonit dhe suvatë. Të jetë i pershtatshem për hidroizolimimin e sipërfaqëve të cilat janë subjekt i vibrimeve dhe i deformimeve të ndryshme.

#### Karakteristikat teknike:

- Natyra e lidhësit: Komponenti A (pluhur) + Komponenti B (lëng).
- Pesha specifike: 1.4 - 1.6 kg/litër (komp A) dhe 1 - 1.2 kg/litër (komp B)
- Raporti i përzierjes:  $\approx$  2-3 kg komp A + 1 litër komp B
- Konsumi teorik: 3-4 kg /m<sup>2</sup>/ 1 mm shtresë
- Djegshmëria: i padjegshëm
- Temperatura e punueshmërisë: në intervalin + 5°C - +30°C
- Magazinimi: Në temperatura në intervalin + 5°C - +30°C në ambient të thatë
- Jetëgjatësia: jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi
- Paketimi: Komponenti A në thasë letre ose të plastifikuar 20 - 30 kg  
+ Komponenti B në bidon plastik ose metalik 5 – 10 kg

#### **45. Hinka për ulluqe horizontale**

Hinkat të jenë të përshtatshme për aplikimin në sistemet e ulluqeve dhe të jenë të përbëra prej materiali cilësor PVC si dhe rezistent përkundrejt agjentëve atmosferikë. Përmasat standarte.

#### **46. Kasete shkarkimi për ulluqe**

Kasetat të jenë të përshtatshme për aplikimin në sistemet e ulluqeve dhe të jenë të përbëra prej materiali cilësor si dhe rezistent përkundrejt agjentëve atmosferikë. Përmasat standarte.

#### **47. Kapëse të ndryshme për ulluqe**

Kapëset të jenë të përshtatshme për aplikimin në sistemet e ulluqeve dhe të jenë të përbëra prej materiali cilësor si dhe rezistent përkundrejt agjentëve atmosferikë. Përmasat standarte.

#### **48. Këndore për ulluqe**

Këndoret të jenë të përshtatshme për aplikimin në sistemet e ulluqeve dhe të jenë të përbëra prej materiali cilësor si dhe rezistent përkundrejt agjentëve atmosferikë. Përmasat standarte.

#### **49. Kapak fundor për ulluqe horizontale**

Kapaku fundor të jetë i përshtatshëm për aplikimin në sistemet e ulluqeve dhe të jetë i përbërë prej materiali cilësor si dhe rezistent përkundrejt agjentëve atmosferikë. Përmasat standarte.

#### **50. Këndore shkarkuese për ulluqe**

Këndoret shkarkuese të jenë të përshtatshme për aplikimin në sistemet e ulluqeve dhe të jenë të përbëra prej materiali cilësor si dhe rezistent përkundrejt agjentëve atmosferikë. Përmasat standarte.

#### **51. Kulmore llamarine për ulluqe**

Kulmoret duhet të jenë të përshtatshme për aplikimin në sistemet e ulluqeve dhe të jenë të përbëra prej materiali cilësor si dhe rezistent përkundrejt agjentëve atmosferikë. Përmasat standarte.

#### **52. Kapuç metalik për panele sanduiç**

Aksesor i domosdoshëm për montimin dhe fiksimin e panele të ndryshme sanduiç, falë formës së tij kompakte dhe tepër dinamike ofron një kapje të sigurtë dhe izolim perfekt fal gominës izoluese. Tipi: Kapuç metalik, Materiali: Metal i IyerPërmasat: 35 x 40mm.

### 53. Katrama për izolim pa kokrriza rëre

Katrama për dorën e parë të izolimit pa kokrriza rëre. Membranë bituminoze plastomerike të jetë e bazuar në një përzierje të bitumeve të distiluara dhe polimereve termoplastike (APP, IPP) të cilësisë së lartë. Sipërfaqja e sipërme e membranës nën sipërfaqe të ketë një shtresë të hollë polietileni që mund të shkrihet lehtësisht me pajisje ngrohëse (kanellë/torçë). Të ketë një fortësi të shkëlqyer dhe të sigurojë hidroizolim të plotë të ujit. Të jetë e përshtatshme për përdorim dorën e parë pa shtresë granili.

#### Karakteristikat teknike:

- Tipi: Pa granil
- Dendësia:  $\geq 4\text{kg/m}^2$
- Trashësia:  $\geq 4\text{mm}$
- Gjatësi: 15-20m
- Gjerësia: 1-1.2m

#### STANDARTET TEKNIKE QË DUHET TË PËRMBUSHË:

- Standartet Shqiptare SSH EN 13707 Fletë fleksibël për hidroizolim - Fletë bitumi e armuar për hidroizolim çatie - Përkufizime dhe karakteristika dhe SSH EN 13969 Fletët fleksibël për hidroizolim - Fletët prej bitumi për hermetizim të lagështisë, duke përfshirë fletët prej bitumi të bazamentit të depozitës - Përcaktimet dhe karakteristikat ose ekuivalentet e tyre.

### 54. Katrama për izolim me kokrriza rëre

Membranë bituminoze plastomerike të jetë e bazuar në një përzierje të bitumeve të distiluara dhe polimereve termoplastike (APP, IPP) të cilësisë së lartë. Sipërfaqja e sipërme e membranës nën sipërfaqe të ketë një shtresë të hollë polietileni që mund të shkrihet lehtësisht me pajisje ngrohëse (kanellë/torçë). Të ketë një fortësi të shkëlqyer dhe të sigurojë hidroizolim të plotë të ujit. Të jetë e përshtatshme për përdorim dorën e dytë me shtresë granili nga njëra anë me trashësi 2-3mm.

#### Karakteristikat teknike:

- Tipi: Pa granil
- Dendësia:  $\geq 4\text{kg/m}^2$
- Trashësia:  $\geq 4\text{mm}$
- Gjatësi: 15-20m
- Gjerësia: 1-1.2m

#### STANDARTET TEKNIKE QË DUHET TË PËRMBUSHË:

- Standartin Shqiptar SSH EN 13707 Fletë fleksibël për hidroizolim - Fletë bitumi e armuar për hidroizolim çatie - Përkufizime dhe karakteristika ose ekuivalentin e tij.

### 55. Ngjitës për pllaka (kollë)

Ky produkt duhet të ketë aftësi optimale ngjitëse në çdo lloj suporti tradicional, si dhe duhet të ketë karakteristika të mira të papërshkueshmërisë nga uji. Të jetë i përshtatshëm për aplikim në shtresa deri në 5 mm, fortësimi të jetë uniformë, pa tkurrje dhe gropëzim të shtresës. Të jetë i klasifikuar sipas kushteve teknike. Të jetë i përshtatshëm për ngjitjen e pllakave prej qeramike, gresporcelan dhe dysheme me bazë çimento për ambiente të jashtme dhe të brendshme.

#### Karakteristikat teknike:

- Temperatura e punës:  $+5^{\circ}\text{C}$  deri në  $+35^{\circ}\text{C}$ .
- Pesha specifike:  $1500-1700\text{ kg/m}^3$
- Koha e hapjes:  $\geq 20\text{ min}$
- Forca e ngjitjes:  $\geq 0.5\text{ N/mm}^2$
- Paketimi: në thasë 20-30 kg

### **56. Ngjitës special për tulla xhami (kollë speciale)**

Ky produkt duhet të jetë një ngjitës special me bazë çimentoje, e modifikuar me polimer dhe e përshtatshme për ngjitjen e tullave prej xhami. Duhet të ketë punueshmëri të shkëlqyer, ngjitje të jashtëzakonshme në tulla të xhamit dhe të jetë rezistente ndaj gërryerjes dhe lagështirës. Ky produkt duhet të përdoret për ngjitjen dhe fugëzimin e tullave prej xhami.

#### Karakteristikat teknike:

Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C.
Pesha specifike:	1500-1700 kg/m <sup>3</sup>
Koha e hapjes:	≥ 30 min
Rezistenca në shtypje:	≥ 10 N/mm <sup>2</sup>
Rezistenca në përkulje:	≥ 5 N/mm <sup>2</sup>
Paketimi:	në thasë 20- 30 kg

### **57. Llamarinë e kalandruar për fuga**

Llamarina duhet të jetë e prodhuar me procesin e kalandrimin, spesori 0.8 mm- 1.5 mm.

### **58. Llamarinë e zezë**

Ky produkt përdoret për të ndertuar konstruksionet metalike në banesa, në ndertesa civile dhe industriale, kapanone etj. Profili është të jetë i përbërë nga hekur i cilësisë së lartë, nga material i pastër e jo i ricikluar për të siguruar jetëgjatësi dhe fortësi ndaj goditjeve mekanike. Bashkimi është bërë me anë të saldimit. Materiali është çelik sipas standartit S235JR ose ekuivalent. Dimensionet: 100x200 cm. Spesori: 2 mm.

### **59. Llamarinë xingato e valëzuar**

Ky lloj modeli llamarine të jetë e përshtatshme për realizimin e kulmeve, tavaneve etj. Të jetë trajtuar me proces të ftohtë të profilizuar. Të jetë dizenuar për të garantuar peshë të reduktuar dhe karakteristika të larta statike. Llamarina të jetë zingato kundër ndryshkjes dhe me punim valëzor. Dimensionet: 100x200 cm dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Spesori: 0.3-0.4 mm.

### **60. Llamarinë e kodrinuar**

Ky produkt përdoret për të ndertuar konstruksionet metalike në banesa, në ndertesa civile dhe industriale, kapanone etj. Profili është të jetë i përbërë nga hekur i cilësisë së lartë, nga material i pastër e jo i ricikluar për të siguruar jetëgjatësi dhe fortësi ndaj goditjeve mekanike. Bashkimi është bërë me anë të saldimit. Materiali është çelik sipas standartit S235JR ose ekuivalent. Dimensionet: 100x200 cm. Spesori: 2 mm.

### **61. Litar me trashësi 12mm**

Litari të jetë prej lini natyral me trashësi Ø12mm dhe të ketë një fushë përdorimi të gjerë në ambiente të jashtme qoftë dhe me lagështirë. Litari të jetë rezistent ndaj ujit, vajit, naftës. Materiali prej lini natyral e bën këtë litar të ketë qëndrueshmëri dhe të jetë i lehtë në përdorim. Ngarkesa mbajtëse të jetë jo më pak se 350 kg.

### **62. Hidroizolues bikomponent për ambiente të brendshme dhe të jashtme**

Material hidroizolues dy komponentësh me bazë çimentoje, me bazë çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës për mure, tarraca, themele dhe bodrume. Të ketë elasticitet dhe granulometri të seleksionuar, aditivësh specialë dhe polimere sintëitike në dispersion ujor dhe me funksion mbrojtës për tarraca. Duke përzier dy komponentët, përftohet një masë që mund të aplikohet edhe në sipërfaqe vertikale, me një trashësi deri në 1 mm për shtresë dhe falë përmbajtjes së lartë të rezinave sintëitike dhe



cilësive të tyre, ai garanton një ngjitje të shkëlqyer në të gjitha sipërfaqet e betonit, tullave dhe qeramikes. Pas fortësimin, ai krijon një shtresë hidroizoluese dhe elastike, rezistente ndaj agentëve atmosferikë. Të jetë i përdorshëm për shtrimin e membranave hidroizoluese përpara vendosjes së pllakave për brenda dhe jashtë. Të realizojë mbrojtje dhe të jetë rezistente ndaj ujit e lagështisë për sipërfaqet e betonit dhe suvatë. Të realizojë nivelim hidroizolues dhe elastik i suvave të plasaritura dhe të përdoret si veshje hidroizoluese dhe mbrojtëse e mureve në themele. Të jetë i përshtatshëm për hidroizolim të sipërfaqeve të cilat janë subjekt i vibrimeve dhe i deformimeve të ndryshme.

Karakteristikat teknike:

- Natyra e lidhësit: Komponenti A (pluhur) + Komponenti B (lëng).
- Peshat specifike: 1.4 - 1.6 kg/litër (komp A) dhe 1 - 1.2 kg/litër (komp B)
- Raporti i përzierjes: ≈ 2-3 kg komp A + 1 litër komp B
- Konsumi teorik: 3-4 kg /m<sup>2</sup>/ 1 mm shtresë
- Djegshmëria: i padjegshëm
- Temperatura e punueshmërisë: në intervalin + 5°C - +30°C
- Magazinimi: Në temperatura në intervalin + 5°C - +30°C në ambient të thatë
- Jetëgjatësia: jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi
- Paketimi: Komponenti A në thasë letre ose të plastifikuar 20 - 30 kg  
+ Komponenti B në bidon plastik ose metalik 5 – 10 kg

**63. Ngjitës për metal**

Ngjitës me dy komponentë për metal. Të jetë ideal për riparime në objekte metalike të cilat kanë nevojë për t'u rezistuar kushteve ekstreme (forcave, vibracionin, ujë, presione të rënda). Të jetë i përshtatshëm për të ngjitur vrimat në radiatorët e kaloriferëve. Të jetë i përshtatshëm për ngjitje në metale (çelik, alumin, hekur). Të jetë rezistent në temperatura nga -30°C deri +120°C. Forca e ngjitjes të jetë jo më pak se 200kg/cm<sup>2</sup>. Volumi 20-30 ml.

**64. Mbjatëse sergjeni 90 gradë**

Të jetë e përshtatshme për montimin dhe mbajtjen e sergjenave të jashtëm. Të jetë prej metali dhe lehtësisht e montueshme në sipërfaqe muri, druri dhe betoni. Materiali çelik. Përmasat: gjerësia e krahut 3-5 cm, gjatësia e krahut 10-15cm.

**65. Mbulesë dyshemeje për ruajtje nga punimet**

Ky produkt të përbëhet nga material karton me dy shtresa, në njërin anë të jetë me kanale ndersa ana tjetër sipërfaqe e drejtë. Të amortizojë goditjet fizike. Përmasat sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

**66. Ngjitës për panelet e izolimit termik**

Ky produkt shërben për fiksimin e paneleve termoizoluese EPS dhe të paneleve minerale, si dhe për të aplikuar një shtresë e hollë të përforcuar me rrjetë për izolimin termik të ndërtesave. Të jetë ngjitës dhe suva e armuar, me përmbajtje me polimere dhe fibra, me bazë çimento. Të jetë e përshtatshme për të ngjitur panelet termoizoluese në objektet e reja, si edhe në ndërtesat ekzistuese që do rinovojnë fasadat me sistem termoizolues. Të ketë rezistencë të lartë ndaj presionit dhe qëndrueshmëri në kohë.

Karakteristikat teknike:

- Përzierja me ujë: 20-25%
- Densiteti: 1.3 - 1.6 kg/lit
- Forca ngjitëse: ≥ 5 N/mm<sup>2</sup>
- Paketimi: Thes 20-30 kg

### **67. Ngjitës universal për tuba PVC**

Ky produkt të jetë ngjitës i fortë për tuba plastike PVC, furnizimi me ujë dhe kanalizimesh ujrash të zeza. Të rezistojë në diferencën e temperaturës, në ujë të ftohtë dhe të ngrohtë, vibrime dhe vjetërsi. Të ketë dendësi të qëndrueshme që lejon mbushjen e boshllëqeve të tubave që paraqiten gjatë montimit të pajisjeve dhe të ketë rezultat ngjitjen e pathyeshme të tyre. Dendësia 1-1.2 kg/lt. Rezistenca maksimale  $\geq 15$  bar. Të ofrohet në kuti plastike ose metalike me volum nga 0.2 litra deri 0.5 litra.

### **68. Panele alumini për fasada (etalbond)**

Panelet e aluminit për fasada janë materiale të përbëra nga mbushje polietileni e përforcuar me alumin si material veshës dhe mbulues. Ky lloj paneli ka rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë, dhe stabilitet kundrejt rrezeve UV. Është një material i fortë dhe rezistent edhe gjatë kalimit të viteve. Përmasat sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Trashësia e pllakës 3-4mm. Trashësia e veshjes së aluminit 0.2-0.3mm. Dendësia e shtresës së polietilenit  $\geq 0.9$  g/cm<sup>3</sup>. Ngjyra: sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

### **69. Panel sanduiç 3cm për mbulesë**

